



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E PROKURORIT TE PËRGJITHSHËM

UDHËZIM

NR. 03 DATË, 12 . 12.2008

PËR

TRANSFERIMIN E PERSONAVE TË DËNUAR NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË E ITALISË

Në mbështetje të Konventës së Këshillit të Evropës "***Për transferimin e personave të dënuar***", "ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8499, datë 10.06.1999, "***Marrëveshjes Shtesë të Konventës së Këshillit të Evropës për transferimin e personave të dënuar***", ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë, ratifikuar me Ligjin nr. 9169, datë 22.01.2004 , nenet 512 - 518 të Kodit të Procedurës Penale, Ligjit për Prokurorinë;

Me qëllim,

- i. Rritjen e efikasitetit në bashkëpunimin juridiksional sa i takon transferimit të të dënuarve ndërmjet Republikës së Italisë e Shqipërisë;
- ii. Rregullimin e unifikimin e procedurës së transferimit të të dënuarve, shtetas shqiptarë, të cilët vuajnë dënimin me burgim në bazë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, dhënë nga autoritetet gjyqësore italiane;
- iii. Përcaktimin e modaliteteve për realizimin e kësaj forme bashkëpunimi dy-palësh ;

UDHËZOJ:

Në mbështetje të:

- Neni 4 të *Marrëveshjes Shtesë të Konventës Evropiane të 21 Marsit 1983 "Për transferimin e personave të dënuar"*, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë, në të cilin përcaktohet shprehimisht se *"Për ekzekutimin e vendimeve, zbatohet neni 9 paragrafi 1, shkronja (a) e Konventës"*;
- Neni 9 paragrafi 1, shkronja (a), të Konventës së Këshillit të Evropës **"Për Transferimin e Personave të Dënuar"** *"Organet kompetente të shtetit zbatues vazhdojnë ekzekutimin e dënimit menjëherë ose nëpërmjet një vendimi gjyqësor ose administrativ, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 10 të Konventës"*;
- Nenet 512 e vijues të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, mbi zbatimin e vendimeve gjyqësore të huaja;

1) Për transferimin e të dënuarve, shtetas shqiptarë, të cilët vuajnë dënimin me burgim në bazë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, dhënë nga autoritetet e drejtësisë italiane, do të kryhen veprimet përkatëse procedurale, në bazë të neneve 512 e vijues të K.Pr.Penale, me paraqitjen e kërkesës për njohje vendimi gjyqësor të huaj në Gjykatë, duke ju përmbajtur natyrës ligjore e kohëzgjatjes së dënimit, siç është parashikuar në vendimin gjyqësor të shtetit dënues, dhe hequr dorë nga procedura e konvertimit të dënimit, në respektim të rezervës së bërë nga Republika e Italisë, në vështrim të nenit 3, paragrafi 3 të Konventës së Këshillit të Evropës, mbi **"përfundimin e procedurës së konvertimit të dënimit sipas neneve 9, paragrafi 1, pika b) dhe 11 të Konventës së Këshillit të Evropës për Transferimin e Personave të Dënuar"**;

2) Të gjitha vendimet e Gjykatave të Rretheve Gjyqësore, me objekt njohjen e vendimit gjyqësor të formës së prerë për efekt transferimi të të dënuarve, shtetas shqiptarë, nga Republika e Italisë në Republikën e Shqipërisë, të cilat përmbajnë disponim në kundërshtim me sa parashtrohet në pikën 1) të këtij udhëzimi, do të apelohehen nga Prokurori.

PROKURORI I PËRGJITHSHËM
INA RAMA

A handwritten signature in black ink, consisting of several loops and a long horizontal stroke at the end, positioned below the printed name.

Konc. N. Vuci, dt 11.12.08
Miratoi. K. Serreqi

